



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Nr. Prot. 03-02/DPK
Bi Prot. 01-575/16
Prot No. _____
Data 11-02-2016
Datum _____
Date _____

DATË/A:	10.02.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPK/03-02-4510/15
PËR/ZA/TO:	z. Reshit Qafëleshi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Dragashit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion- lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik

I nderuar z. Qafëleshi

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nen paragrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nen paragrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj me numër protokolli 03-02-4510/15, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

O P I N I O N

Punësimi i kandidatit z. Dashnor Qafëleshi, në pozitën zyrtar i ndihmave Sociale ne Qendrën për Pune Sociale ne Komunën e Dragashit ne kohen kur ju jeni Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale mundë të cilësohet si situatë qe sjell konflikt të interesit pasi qe ju jeni babai i tij.

Arsyetim

Agjencia kundër Korrupsionit ka nxjerr vendim me nr. Protokolli AKK-03-02-4510/15 për të trajtuar kërkesën e z. Reshit Qafëleshi, Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Dragashit, për ti dhën një opinion lidhur me sqarimin e situatës që ndërlidhet më një Konkurs në Qendrën për Pune Sociale në Komunën e Dragashit,(ku ka aplikuar djali i tij pra i Drejtorit të Drejtorisë se Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Dragashit i cili ka dalë me pikë më të larta dhe është përzgjedhur nga komisioni vlerësues i rekrutimit, ndërkohë konkursi është anuluar nga komisioni për konteste dhe ankesa i K.K. Dragashit me arsyetimin e shkeljeve procedurale. Për hapjen e konkursit akordohet Drejtori i QSP-së në bashkëpunim me menaxherin e personelit, të aprovuar nga Ministria e Administrimit të pushtetit Lokal. Konkursin e ka shpallur zyra e personelit me kërkesën e Drejtorit të QPS-së). Andaj është kërkuar nga AKK-ja qe të trajton çështjen në fjalë.

Agjencia kundër Korrupsionit, në bazë të kompetencave të parapara me ligj ka trajtuar kërkesën e zyrtarit z. Reshit Qafëleshi, si dhe ka organizuar një takim për të marr informata shtesë, dhe me kujdes ka analizuar përgjegjësit e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Dragashit, qe rrjedhin nga Statuti i kësaj Komune.

Përgjegjësit qe rrjedhin nga Neni 62 i këtij Statuti janë: Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale është përgjegjëse për : a. Ofrimin e kujdesit shëndetësor në komunë, ne pajtim me dispozitat ligjore, b. Inspektimin e qendrave private të për kujdesit primar shëndetësor, c. Vlerësimin e nevojave për shëndetësi primare, d. Vendosjen e objekteve lokale për kujdesin primar shëndetësor, e. Zhvillimin e buxhetit bazuar në nevojat lokale dhe duke respektuar udhëzimet e MSH, f. Koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF,QMF dhe ambulancave, g. Operimin e qendrave për punë sociale dhe qendrave për mirëqenie sociale, h. Zhvillimin e planit strehimor për territorin e komunës, i. Sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit, sipas standardeve të përcaktuara nga MPMS, dhe j. Punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunë.

Nga kjo qe rrjedh nga përgjegjësit e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale ekziston lidhja ne mes të Drejtorisë për Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale dhe Qendrës për Pune Sociale në Komunën e Dragashit.

Bazuar ne mandatin qe ka AKK-ë, ka obligim ligjore qe te bëjë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave, neni 19 (paragrafi 5) i Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Duhet ditur se konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik (nenit 6 i Ligjit nr.04/L-051).

Rrjedhimisht, nga neni 8 i Ligjit nr.04/L-051 (paragrafi 1,2,3,4,5,6) është detyrim për zyrtarin lartë parandalimi i konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Ligji nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik ka kategorizuar zyrtaret e lartë të cilët janë të obliguar qe të respektojnë rregullat dhe parimet qe rrjedhin nga ky ligj.

Zyrtari i lartë z. Reshit Qafleshi, Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale ne Komunën e Dragashit hyn ne listën zyrtareve të lart sipas këtij ligji, pos përgjegjësive dhe kompetencave që lidhen me funksionin e tij ai është i obliguar që të parandalojë dhe të zgjedh vet çdo situatë të konfliktit të interesit.

Po ashtu edhe Ligji Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale ne nenin 63 ka përcaktuar konfliktin e interesit për Drejtorët e Komunës. Sipas kësaj dispozite (63.1) - Drejtorët përjashtohet nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjesh për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij ka ndonjë interes personal ose financiar. 63.2 Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash menjëherë pasi shfaqen. 63.3 Statuti dhe Rregullorja e punës përfshijnë masat të cilat merren për të përjashtuar drejtorët nga vendimmarrja dhe procedurat administrative ku ata kanë ndeshje interesash.

Konsiderojmë se punësimi i z. Dashnor Qafëleshi ne këtë konkurs do te ishte shkak për lindjen e konfliktit të interesit dhe do te bie ndesh me te gjitha obligimet qe rrjedhin nga dispozitat përkatëse qe e rregullojnë çështjen e parandalimit te konfliktit te interesit, andaj ju rekomandojmë që të veproni konform këtyre dispozitave dhe parimeve të bazuar në Ligjet ne fuqi për të parandaluar dhe shmangur situatën që mund të sjellë gjendje të konfliktit të interesit.

Me respekt

